



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

**Nr. i Dokumentit: 21.4.7-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR RAPORTIN FINANCIAR TË FONDIT TË BASHKUAR PËR**  
**SEKTORIN E ARSIMIT**  
**PËR PERIUDHËN JANAR - MARS 2016**

*Auditim në bazë të marrëveshjes me MASHT/FBSA*

**Prishtinë, dhjetor 2016**

Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit mbi Raportin Financiar të Fondit të Bashkuar në Sektorin e Arsimit, në konsultim me Udhëheqësin e Divizionit, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga Udhëheqësja e ekipit Luljeta Ajazi Sylaj dhe Anëtarja e ekipit Arnisa Aliu.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Raporti financiar dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Rekomandimet e vitit paraprak.....	8
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	9
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	12
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	13
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	15

## Përmbledhje e përgjithshme


### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i raportit financiar të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit për periudhën janar-mars të vitit 2016, i cili e përcakton konkluzionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë stafin e Ministrisë për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Fondi i Përbashkët në Sektorin e Arsimit është një fond i krijuar nga një grup i partnerëve kontribues për zhvillim për të mbështetur planet zhvillimore në sektorin e arsimit. Ky fond është krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të, Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian) dhe Partnerëve për Zhvillim (Suedisë/SIDA dhe Agjencisë për Zhvillim të Austrisë). Kohëzgjatja e paraparë e projektit fillimisht ishte 2013 - 2015, dhe kishte për qëllim mbështetjen e planit për ndërtimin e kapaciteteve në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencitë e saj qendrore. Pasi që aktivitetet nuk ishin përfunduar plotësisht, me kërkesën e Ministrisë, kohëzgjatja e projektit ishte zgjatuar deri më 15 mars 2016.

Ekzaminimi i shpenzimeve për vitin 2016 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

**Opinion i pamodifikuar**

Raporti financiar për periudhen janar – mars 2016, *paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

**Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në pjesët individuale të shpalosura brenda këtij raporti konkluzioni ynë i përgjithshëm është se ekziston një raportim i plotë financiar në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Gjithashtu menaxhimi financiar dhe kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efikase, me përjashtim të disa çështjeve të rëndësisë së ulët materiale. Poashtu, produktet e dala nga ky projekt nuk janë plotësisht funksionale dhe nuk janë duke u aplikuar nga Ministria (me përjashtim të vlerësimit të stafit dhe planifikimit të integruar).

# 1 Raporti financiar dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i raportit financiar tremujor merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në raport. Po ashtu ne kemi konsideruar edhe krahasimin e realizimit të shpenzimeve në raport me planifikimin e aktiviteteve të projektit.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### Opinioni

Ne kemi audituar raportin financiar të Projektit “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ Fondi i Bashkuar për Sektorin e Arsimit” (MASHT/FBSA) për periudhën janar-mars 2016, i cili përfshinë, një përmbledhje të Krahasimit të Buxhetit me Shumat Aktuale dhe Shënimet shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, raporti financiar paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të gjendjes financiare të shpalosur të Projektit MASHT/FBSA për periudhën janar-mars 2016, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme) dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është e pavarur nga MASHT/FBSA dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmia e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për raportimin financiar

Menaxhmenti i MASHT-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raporteve financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur

përgatitjen e raporteve financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Sekretari i Përgjithshëm dhe Komiteti Drejtues i MASHT/FBSA janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të projektit.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e raportit financiar**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për raportin financiar në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse raportet financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse raportet financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ai ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve që marrin për bazë këto raporte financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në raportet financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e raporteve financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të raporteve financiare.

Një përshkrim i mëtejshëm i përgjegjësive të auditorit për auditimin e raporteve financiare të MASHT/FBSA është vendosur në marrëveshjen e nënshkruar nga Auditori i Përgjithshëm dhe Kryesuesi i Komitetit Drejtues të MASHT/FBSA.

## 1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim

MASHT/FBSA sipas marrëveshjes për themelim kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar ligjore, dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Marrëveshjen bazë për themelimin e FBSA-së, dhe aprovimet për vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, me ndryshime dhe plotësime; dhe
- Rregulloret e thesarit në lidhje me shpenzimin e parave publike.

Në kontekst të raportimit, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Në lidhje me fondet e shpenzuara nga MASHT/FBSA është përgatitur raporti përmbledhës, derisa ky raport më tej do të përfshihet në Pasqyrat Financiare Vjetore të “Konsoliduara” të MASHT-it. Në lidhje me progresin e projektit është raportuar në baza të rregullta tremujore.

Në kontekst të kërkesave për raportim, dhe sa i përket performancës së projektit ne kemi vërejtur se akoma nuk është bërë raporti final i performancës, dhe se produktet e dalura nga projekti nuk kanë arritur të futen në përdorim nga ministria (me përjashtim të vlerësimit të performancës së stafit dhe planifikimit të integruar). Rregulloret për planifikimin si dhe ajo për menaxhimin e buxhetit janë aprovuar nga menaxhmenti i Ministrisë.

## 1.4 Rekomandimet

**Rekomandimi 1** Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it duhet të siguroj që produktet e dala nga projekti të futen në përdorim të plotë në mënyrë që proceset të lehtësojnë dhe ndihmojnë menaxhimin e aktiviteteve brenda ministrisë.

## 2 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015 të MASHT/FBSA ka rezultuar në katër rekomandime. Komiteti Drejtues e ka diskutuar raportin në takimet e tyre, megjithatë nuk është hartuar ndonjë plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të auditimit. Rrjedhimisht kanë munguar veprimet konkrete për implementimin e rekomandimeve tona. Për detaje shih shtojcën III të këtij raporti.

Ky projekt tashmë ka përfunduar, megjithatë, ne rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të MASHT-it që për projektet e ardhshme, pas përfundimit të raporteve të auditimit të hartojë plane të veprimit për implementimin e rekomandimeve, si dhe të monitorojë implementimin e tyre në baza të rregullta kohore.



## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne kemi konsideruar menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe procesin e pagesave.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MASHT/FBSA, janë zbatuar rregulloret e kërkuara, dhe ne nuk kemi ndonjë shqetësim për të theksuar. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të forta dhe janë zbatuar në mënyrë efektive me disa vërejtje të vogla sa i përket shpenzimeve jashtë planit kohor. Kontrollet sa i përket realizimit me kohë të projektit nuk kanë funksionuar mirë. Si rezultat projekti edhe pse fillimisht ishte paraparë të përfundojë në fund të vitit 2015, dhe pastaj është zgjatuar deri me 15 mars 2016, disa aktivitete dhe pagesa janë bërë pas kësaj periudhe.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MASHT/FBSA, dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Për vitin 2016, MASHT/FBSA kishte një burim të fondeve nga SIDA Suedeze. Sa i përket kategorive ekonomike, të gjitha shpenzimet e MASHT/FBSA ndërlidhem me mallra dhe shërbime. Shpenzimet e ndodhura dhe krahasimi me buxhetin janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1. Fondet buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti i alokuar - 2016	Shpenzimet e buxhetit për 2016	Pjesa e pashpenzuar
Asistenca Teknike për MASHT	262,893	262,892	1
Shpenzimet e paparashikuara	42,192	38,150	4,042
Kurset e gjuhës angleze	35,769	-	35,769
Procesi i QTS-Rishikimi i Përbashkët Vietor	223	-	223
Verifikimi i buxhetit/auditimi i FBSA	2,780	-	2,780
<b>Totali</b>	<b>343,858</b>	<b>301,042</b>	<b>42,816</b>

Në vitin 2016 MASHT/FBSA ka përdorur 301,042€, ose 87.5% të buxhetit, me një përmirësim prej 15% krahasuar me vitin 2015.

## Çështja 2 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Realizimi i buxhetit është përmirësuar në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë një pjesë e aktiviteteve dhe pagesave, edhe pse janë të ndërlidhura me aktivitetet e projektit, janë kryer pas afatit të përfundimit të projektit. Bëhet fjalë për një punëtori e cila është mbajtur jashtë shtetit me 1-3 prill 2016, me qëllim të finalizimit të disa dokumenteve, udhëzimeve administrative dhe procedurave standarde operative të cilat ndërlidhen me projektin. Vlera totale e shpenzimeve të udhëtimit/puntorisë ishte 4,879€.
- Rreziku** Realizimi i aktiviteteve pas përmbylljes së afatit të paraparë të projektit është në kundërshtim me marrëveshjen dhe si të tilla pagesat mund të konsiderohen si të parregullta.
- Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it duhet të diskutojë me donatorët në lidhje me këtë shumë, për të parë mundësitë eventuale që ato mjete të aprovohen si shpenzime të projektit. Në të kundërtën mjetet e tilla duhet t'i kthehen donatorit.

## 3.4 Prokurimi

Shpenzimet e realizuara në 2016, përmes procedurave të prokurimit ishin mbi 279,000€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshinë kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe ekzekutimin e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Të gjitha kontratat në lidhje me projektin janë nënshkruar në vitet e mëhershme dhe disa nga to kanë qenë subjekt i auditimeve të kaluara. Për këtë vit ne kemi ekzaminuar vetëm pagesat për të verifikuar nëse ato kanë qenë në pajtim me kontratat dhe rregullat tjera të zbatueshme. Auditimi nuk ka evidentuar ndonjë mangësi në këtë drejtim.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### 3.5.1 Avanset për udhëtime, trajnimet etj.

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam 6 pagesa në vlerë 18,108€. Pjesa më e madhe e tyre ka të bëjë me udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit, akomodimin dhe shpenzimet e trajnimit.

Përveç çështjes 1, e cila është përshkruar tek pjesa 3.3 e këtij raporti - realizimi i buxhetit, auditimi nuk ka vërejtur ndonjë mangësi tjetër për t'u raportuar.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri/SP duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

### (e shkëputur nga ISSAI 200)

#### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

#### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

#### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Pjesërisht të implementuara	Të pa implementuara
<b>Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim</b>	Komiteti drejtues duhet të siguroj që për pjesën e mbetur të shpenzimeve të bartura për vitin 2016 të përgatitet një raport detal dhe t'i dërgohet partnerëve participues në projekt për të siguruar se buxheti është shfrytëzuar për qëllimet e synuara dhe në harmoni me rregullat e kërkuara. Për auditimin e kësaj pjese të shpenzimeve duhet të bëhet një aneks kontratë me ZAP apo të kontraktohet ndonjë kompani tjetër, varësisht nga ajo se si vendos Komiteti Drejtues dhe Partnerët.		Pjesërisht	
<b>Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit</b>	Komiteti Drejtues duhet të sigurojë që realizimi i buxhetit dhe aktiviteve të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore, duke identifikuar dhe adresuar barrierat që ndikojnë në realizimin e buxhetit.			Jo
<b>Shpenzimet përmes prokurimit</b>	Këshilli Drejtues duhet të kërkoj nga zyrtarët e përfshirë në menaxhimin e aktiviteve të projektit që të jenë më të vëmendshëm gjatë menaxhimit të aktiviteve për të shmangur shpenzimet e panevojshme.			Jo
<b>Shpenzimet jo përmes prokurimit</b>	Komiteti Drejtues duhet të sigurojë që nga mjetet e projektit të financohen vetëm aktivitetet e planifikuara. Për çdo ndryshim eventual duhet të vendos Komiteti Drejtues pas marrjes së pëlqimit nga partnerët donator.			Jo